

LIGJ
Nr.9242, datë 17.6.2004

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE ANTIDOPING, 1989”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa Europiane Antidoping, 1989”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4270, datë 14.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KËSHILLI I EUROPËS, KOMITETI DREJTUES PËR ZHVILLIMIN E SPORTEVE (CDDS),
KONVENTA EUROPIANE ANTIDOPING STRASBURG, 16.XI. 1989

PREAMBUL

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtete të tjera palë në Konventën Kulturore Europiane dhe shtete të tjera nënshkruese të saj,

duke gjykuar se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të gjerë midis anëtarëve të saj, me synim mbrojtjen dhe zbatimin e idealeve dhe parimeve, të cilat përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët, dhe lehtësimin e zhvillimit të tyre ekonomik dhe shoqëror;

të vetëdijshëm që sporti duhet të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit, në edukimin moral dhe fizik dhe në nxitjen e mirëkuptimit ndërkombëtar;

të shqetësuar për përdorimin në rritje të agjentëve dhe metodave doping nga sportistë të të dyja gjinive gjatë ushtrimit të sportit dhe pasojave që rrjedhin për shëndetin e pjesëmarrësve dhe për të ardhmen e sportit;

të bindur që ky problem vë në rrezik parimet etike dhe vlerat edukative të mishëruara në Kartën Olimpikë, në Kartën Ndërkombëtare për Sportin dhe Edukimin Fizik të UNESCO-s dhe në Rezolutën (76) 41 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, të njohura si “Karta Europiane e Sportit për të Gjithë”;

duke pasur parasysh rregullat kundër dopingut, politikat dhe deklaratat e miratuara nga organizatat sportive ndërkombëtare;

të ndërgjegjshëm që autoritetet publike dhe organizatat sportive vullnetare kanë përgjegjësi të ndërsjellë për të luftuar dopingun në sport, veçanërisht për të siguruar një administrim të përshtatshëm, mbi bazën e parimit të sjelljes së ndershme, të veprimtarive sportive dhe për të mbrojtur shëndetin e atyre që marrin pjesë në to;

duke iu referuar rezolutave mbi dopingun të miratuara nga Konferenca e Ministrave Europiane Përgjegjës për Sportin dhe në veçanti Rezolutën nr.1 të miratuar në Konferencën e 6-të në Rejkjavik në 1989;

duke kujtuar që Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës tashmë ka miratuar Rezolutën (67) 12 mbi dopingun e sportistëve, Rekomandimin No.R (79) 8 mbi dopingun në sport, Rekomandimin No.R (84) 19 mbi “Kartën Europiane Antidoping për Sportin” dhe Rekomandimin No.R (88) 12 mbi kryerjen e kontroleve doping pa paralajmërim, jashtë garave;

duke iu referuar rekomandimit Nr.5 mbi dopingun miratuar nga Konferenca e Dytë Ndërkombëtare e Ministrave dhe Zyrtarëve të Lartë Përgjegjës për Sportin dhe Edukimin Fizik organizuar nga UNESCO në Moskë (1988);

të vendosur për të ndërmarrë veprime bashkëvepruese të mëtejshme dhe më të fuqishme, me synim pakësimin dhe mënjanimin e mundshëm të dopingut në sport, duke përdorur si bazë vlerat etike dhe masat praktike që këto mjete përmbajnë,

bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i Konventës

Me synim pakësimin dhe mënjanimin e mundshëm të dopingut në sport, Palët angazhohen, brenda kufijve që e lejojnë dispozitat e tyre kushtetuese përkatëse, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 2

Përcaktimi dhe qëllimi i Konventës

1. Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “Dopingun në sport” nënkupton administrimin nga ana e sportistëve, ose përdorimin prej tyre, të klasifikimeve farmakologjike të agjentëve doping apo metodave doping;

b) “Klasifikimet farmakologjike të agjentëve doping apo metodave doping”, objekt i paragrafit 2 të mëposhtëm, nënkupton ato klasa të agjentëve doping apo metodave doping të ndaluara nga organizatat sportive përkatëse ndërkombëtare dhe që janë të përfshira në listat e aprovuara nga grupi monitorues sipas kushteve të nenit 11.1.b;

c) “Sportistë dhe sportiste” nënkupton ata persona të cilët marrin pjesë rregullisht në aktivitete të organizuara sportive.

2. Deri më tani si listë e klasave farmakologjike dhe agjentëve dhe metodave doping të ndaluara, aprovuar nga grupi monitorues sipas përkufizimit të nenit 11.1.b, do të zbatohet lista referuese në shtojcën e kësaj Konvente.

Neni 3

Bashkëpunimi brenda vendit

1. Palët do të bashkërendojnë politikat dhe veprimet e departamenteve të tyre shtetërore dhe agjencive të tjera publike të interesuara për të luftuar dopingun në sport.

2. Ato do të sigurojnë që ka një zbatim praktik të kësaj Konvente dhe veçanërisht përmbushjen e kërkesave të nenit 7, duke ia besuar, aty ku duhet, zbatimin e disa prej dispozitave të kësaj Konvente një autoriteti sportiv shtetëror ose joshtetëror apo një organizate sportive.

Neni 4

Masat për të kufizuar mundësinë e gjetjes dhe përdorimit të agjentëve dhe metodave doping të ndaluara

1. Palët do të miratojnë, aty ku duhet, një legjisllacion, rregulla apo masa administrative për të kufizuar mundësinë e gjetjes (duke përfshirë masat për të kontrolluar lëvizjen, pronësimin, importimin, shpërndarjen dhe shitjen), si dhe përdorimit në sport të agjentëve dhe metodave të

ndaluara doping dhe në veçanti të steroidëve anabolikë.

2. Për këtë qëllim, Palët ose, kur kërkohet, organizmat sportivë joshtetërorë përkatëse do ta bëjnë kriter të tyre për dhënien e subvencioneve publike organizatave sportive që zbatojnë në mënyrë të efektshme rregullat antidoping.

3. Veç kësaj, Palët:

a) do të ndihmojnë organizatat e tyre sportive për të financuar kontrollet dhe analizat doping, qofshin këto përmes subvencioneve të drejtpërdrejta ose granteve, ose duke njohur koston e këtyre kontrolleve dhe analizave kur përcaktojnë subvencionet ose grantet që do t'u jepen këtyre organizatave;

b) do të ndërmarrin hapat e duhura për të refuzuar dhënien e subvencioneve nga fondet publike, për qëllime trajnimi, sportistëve dhe sportistëve të veçantë, të cilët janë pezulluar si rezultat i përdorimit të dopingut në sport, gjatë periudhës së tyre të pezullimit;

c) do të nxisin dhe, kur duhet, të lehtësojnë kryerjen e kontrolleve doping nga organizmat e tyre sportive që kërkohen nga organizmat sportive kompetente ndërkombëtare, qoftë gjatë ose jashtë garave; dhe

d) do të inkurajojnë dhe lehtësojnë negocimin nga organizatat sportive të marrëveshjeve që i lejojnë anëtarët e tyre të testohen nga ekipe që kanë autoritetin e duhur për kontrolle doping në vende të tjera.

4. Palët rezervojnë të drejtën të miratojnë rregullore antidoping dhe të organizojnë kontrolle doping me nismën e tyre dhe në përgjegjësinë e tyre, me kusht që ato të jenë në përputhje me parimet përkatëse të kësaj Konvente.

Neni 5 **Laboratorët**

1. Secila Palë merr përsipër:

a) të krijojë ose të lehtësojë krijimin, në territorin e saj, të një ose më shumë laboratorëve të kontrollit doping të përshtatshëm për t'u gjykuar për akreditim sipas kriteve të përcaktuara nga organizmat sportive ndërkombëtare përkatëse dhe të aprovuara nga grupi monitorues në përputhje me nenin 11.1.b; ose

b) të ndihmojë organizmat e saj sportivë të kenë mundësi veprimi në laboratorët doping në territorin e një shteti tjetër.

2. Këta laboratorë do të nxiten:

a) të ndërmarrin veprimet e duhura për të punësuar, trajnuar dhe ritrajnuar staf të kualifikuar;

b) të ndërmarrin programe të përshtatshme studimi dhe zhvillimi mbi agjentët dhe metodat doping të përdorura ose që mendohen të përdoren, për qëllime dopingut në sport dhe në biokiminë, në farmakologjinë analitike, me synim arritjen e një kuptimi më të mirë të efekteve të substancave të ndryshme mbi trupin e njeriut dhe pasojat e tyre në rezultatin sportiv të sportistëve;

c) të botojnë dhe të qarkullojnë të dhëna sa më të reja, nxjerrë nga studimet e tyre.

Neni 6 **Edukimi**

1. Palët angazhohen të hartojnë dhe zbatojnë, ku duhet, në bashkëpunim me organizatat sportive të interesuara dhe me masmedian, programe edukuese dhe fushata informuese, duke e vënë theksin mbi rreziqet e dopingut ndaj shëndetit dhe dëmin që shkakton ai mbi vlerat etike të sportit. Këto programe dhe fushata do të jenë jo vetëm për të rinjtë në shkolla dhe në klube sportive, por njëkohësisht dhe për prindërit e tyre dhe sportistët e rritur, zyrtarët sportivë, drejtuesit dhe trajnerët. Për ata që janë të fushës së mjekësisë, këto programe edukuese do të vënë theksin në respektimin e etikës mjekësore.

2. Palët angazhohen të inkurajojnë dhe mbështesin studime, në bashkëpunim me organizatat sportive ndërkombëtare rajonale dhe kombëtare të interesuara, me mjete dhe mënyra shkencore të bazuara në programe trajnuese fiziologjike dhe psikologjike që respektojnë integritetin e njeriut.

Neni 7

Bashkëpunimi me organizatat sportive mbi masat që ata duhet të ndërmarrin

1. Palët anagazhohen të nxisin organizatat e tyre sportive dhe nëpërmjet tyre organizmat sportive ndërkombëtare, për të formuluar dhe zbatuar të gjitha masat e duhura, brenda kompetencave të tyre, kundër përdorimit të dopingut në sport.

2. Për këtë qëllim, ata do të inkurajojnë organizatat e tyre sportive të qartësojnë dhe harmonizojnë të drejtat, detyrimet dhe detyrat e tyre përkatëse, veçanërisht duke harmonizuar:

a) rregullat e tyre antidoping mbi bazën e rregullave të aprovuara nga organizmat respektive ndërkombëtare sportive;

b) listat e tyre të klasave farmakologjike të agentëve dhe metodave doping të ndaluara mbi bazën e listave të aprovuara nga organet respektive ndërkombëtare sportive;

c) procedurat e kontrollit doping;

d) procedurat disiplinore, duke zbatuar parimet ndërkombëtare të miratuara të drejtësisë dhe duke siguruar respektimin e të drejtave themelore të sportistëve dhe sportistëve të dyshuar; këto parime do të përfshijnë:

i) organet raportuese dhe disiplinore të dallueshme nga njëra-tjetra;

ii) të drejtën e këtyre personave për t'u dëgjuar, ndihmuar dhe përfaqësuar;

iii) dispozita të qarta dhe të detyrueshme për apelim ndaj çdo lloj gjykimi të marrë;

e) procedurat për detyrimin (imponimin) ndaj dënimeve në fuqi për zyrtarët, mjekët, mjekët veterinerë, trajnerët, psikoterapistët, zyrtarët apo personel tjetër që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave antidoping nga sportistët dhe sportistët.

f) procedurat për njohjen e ndërsjellë të pezullimeve dhe gjobave të tjera të detyruara nga organizata të tjera sportive në vend apo në një vend tjetër.

3. Gjithashtu, Palët do të inkurajojnë organizatat tyre sportive:

a) të ndërmarrin, në mënyrë sa më të efektshme, kontrole doping jo vetëm në gara, por edhe pa ndonjë njoftim paraprak, në çdo kohë që gjykohet e përshtatshme jashtë garave; këto kontrole duhen kryer në mënyrë të barabartë për të gjithë sportistët dhe duhet të përfshijnë testimin dhe ritestimin e individëve të zgjedhur për kontroll në mënyrë të rastësishme, kur duhet;

b) të hyjnë në marrëveshje me organizatat sportive të vendeve të tjera për të lejuar një sportist apo sportiste që stërvitet në një vend tjetër të testohet nga një ekip i autorizuar për kontrollin doping në atë vend;

c) të qartësojnë dhe harmonizojnë rregulloret mbi mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari sportive të cilat do të përfshijnë dhe kriterin e kontrollit doping;

d) të nxisin një pjesëmarrje aktive të vetë sportistëve në veprimtaritë kundër dopingut të organizmave ndërkombëtare sportive;

e) të përdorin në mënyrë aktive dhe me efikasitet pajisjet për analizat doping në laboratorët e përcaktuar sipas nenit 5 si gjatë, ashtu dhe jashtë garave sportive;

f) të studiojnë metodat shkencore stërvitore dhe të hartojnë udhëzime në përshtatje me çdo disiplinë sportive për të mbrojtur sportistët dhe sportistët e të gjitha moshave.

Neni 8

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Palët do të bashkëpunojnë ngushtësisht për çështje që trajtohen në këtë Konventë dhe do të inkurajojnë të njëjtin bashkëpunim midis organizatave të tyre sportive.

2. Palët angazhohen:

a) të nxisin organizmat e tyre sportive të veprojnë në një mënyrë që mbështet zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente brenda të gjitha organizatave përkatëse ndërkombëtare anëtare të të cilave ata janë, duke përfshirë refuzimin për të miratuar pretendimet për rekordet botërore apo rajonale nëse ato nuk janë të shoqëruara me një raport autentik negativ dalë nga kontrolli doping;

b) të mbështesin bashkëpunimin midis personelit të laboratorëve të tyre të kontrollit doping të

ngritur ose që vepron në përputhje me nenin 5; dhe

c) të iniciojnë bashkëpunime dypalëshe dhe shumëpalëshe midis agjencive, autoriteteve dhe organizatave të tyre përkatëse, me qëllim që të arrihen objektivat e përcaktuara në nenin 4.1, në nivel ndërkombëtar.

3. Palët që kanë laboratorë të ngritur apo që veprojnë në përputhje me nenin 5, angazhohen të ndihmojnë Palët e tjera për t'i mundësuar ato të fitojnë përvojën, aftësitë,(zotësitë) dhe teknikat e nevojshme për të ngritur laboratorët e tyre.

Neni 9

Dhënia e informacionit

Secila Palë do t'i paraqesë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në një prej gjuhëve zyrtare të Këshillit të Europës, të gjithë informacionin që lidhet me masat legjislative dhe masat të tjera.

Neni 10

Grupi monitorues

Për qëllime të kësaj Konvente, do të ngrihet një grup monitorues në këtë mënyrë:

1. Secila Palë mund të përfaqësohet në grupin monitorues me një ose më shumë delegatë. Secila Palë do të ketë një votë.

2. Çdo Shtet që përmendet në nenin 14.1, i cili nuk është Palë në këtë Konventë, mund të përfaqësohet në grupin monitorues me një vëzhgues.

3. Grupi monitorues mundet, me vendim unanim, të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, që nuk është Palë në Konventë, dhe çdo organizatë tjetër sportive apo të një natyre tjetër të interesuar për t'u përfaqësuar me një vëzhgues në një ose më shumë mbledhje të tij.

4. Grupi monitorues do të mbliidhet nga Sekretari i Përgjithshëm. Mbledhja e tij e parë do të mbahet sa më shpejt që të shihet e arsyeshme dhe në çdo rast brenda një viti pas datës të hyrjes në fuqi të Konventës. Për rrjedhojë, ai do të mbliidhet sa herë të jetë e nevojshme, me nismën e Sekretarit të Përgjithshëm ose të një Pale.

5. Shumica e Shteteve Palë do të përbëjë quorumin e nevojshëm për mbajtjen e një mbledhjeje të grupit monitorues.

6. Grupi monitorues do të mbliidhet jozyrtarisht.

7. Në varësi të dispozitave të kësaj Konvente, grupi monitorues do të hartojë dhe miratojë me konsensus rregullat e saj procedurale.

Neni 11

1. Grupi monitorues do të monitorojë zbatimin e kësaj Konvente. Në veçanti ai:

a) mund të mbajë në këqyrje dispozitat e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë çdo ndryshim të nevojshëm;

b) mund të aprovojë listën dhe çdo rishikim të saj, të klasave farmakologjike të agjentëve dhe metodave doping të ndaluara nga organizmat respektivë ndërkombëtarë sportivë, të cilave u referohen nenet 2.1 dhe 2.2, dhe kriterin për akreditimin e laboratorëve, dhe çdo rishikim të saj, miratuar nga organizatat e sipërpërmendura, sipas nenit 5.1.a. dhe të fiksojnë datën për hyrjen në fuqi të vendimeve përkatëse;

c) mund të mbajë konsultime me organizatat përkatëse sportive;

d) mund t'u bëjë rekomandime Palëve në lidhje me masat që duhen marrë për qëllime të kësaj Konvente;

e) mund të rekomandojë masat e duhura për të informuar vazhdimisht organizmat përkatës ndërkombëtarë dhe publikun rreth veprimtarive të kryera në kuadër të kësaj Konvente;

f) mund t'i rekomandojë Komitetit të Ministrave në lidhje me shtetet joanëtare të Këshillit të Europës të ftohen për të hyrë në këtë Konventë;

g) mund të bëjë çdo propozim për të përmirësuar efikasitetin e kësaj Konvente;

2. Me qëllim që të shkarkohet nga funksionet e tij, grupi monitorues mundet që, me nismën e

tij, të organizojë takime të grupeve të ekspertëve.

Neni 12

Pas çdo takimi, grupi monitorues do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi punën e tij dhe mbi funksionimin e Konventës.

Neni 13

Amendamente për nene të Konventës

1. Mund të propozohen amendamente në nenet e kësaj Konvente nga një Palë, nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ose nga grupi monitorues.

2. Çdo propozim për amendament do t'i komunikohet shteteve të cituara në nenin 14 dhe çdo shteti që ka aderuar ose që është ftuar të aderojë në këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e nenit 16, nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Çdo amendament të propozuar nga një Palë ose nga Komiteti i Ministrave do t'i komunikohet grupit monitorues të paktën dy muaj para takimit ku ky amendament do të merret në konsideratë. Grupi monitorues do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave mendimin e tij mbi amendamentin e propozuar, kur e sheh me vend pas konsultimit me organizatat përkatëse sportive.

4. Komiteti i Ministrave do të marrë në konsideratë amendamentin e propozuar dhe çdo mendim të paraqitur nga grupi monitorues dhe mund të miratojë amendamentin.

5. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni do t'i dëgohet Palëve për aprovim.

6. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të periudhës prej një muaji kur të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij.

KLAUZOLA TË FUNDIT

Neni 14

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga çdo shtet anëtar i Këshillit të Europës, shtetet e tjera palë në Konventën Kulturore Europiane dhe shtetet joanëtare, të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, të cilat mund të shprehin miratimin e tyre të kushtëzuar nga:

- a) nënshkrimi pa rezervë ndaj ratifikimit, pranimit apo aprovimit ose
- b) nënshkrimi subjekt ratifikimi, pranimit apo aprovimi, i pasuar nga ratifikimi, pranimit ose aprovimi.

2. Mjetet e ratifikimit, pranimit apo aprovimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 15

1. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës pas skadimit të periudhës prej një muaji pas datës kur të pesë shtetet, duke përfshirë të paktën katër shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur aprovimin e tyre të veprojnë në përputhje me Konventën sipas dispozitave të nenit 14.

2. Përsa i përket çdo shteti nënshkrues, i cili për rrjedhojë shpreh miratimin e tij për të vepruar në përputhje me të, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej një muaji pas datës së nënshkrimit ose të depozitimit të mjetit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 16

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve me shtetet palë, mund të ftojë për të aderuar në Konventë çdo shtet joanëtar me anë të një vendimi të marrë me shumicë, bazuar në nenin 20.d të statutit të Këshillit të Europës, dhe me votim unanim të përfaqësuesve të Shteteve Kontraktuese që gëzojnë të drejtën për të patur vende në këtë

Komitet.

2. Në lidhje me ndonjë shtet që aderon, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej një muaji pas datës së depozitimit të mjetit të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 17

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton mjetin e tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit, specifikon territorin ose territoret mbi të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në çfarëdo date të mëvonshme, i shpreh Sekretarit të Përgjithshëm, nëpërmjet një deklarate në adresë të tij, shtrirjen e zbatimit të kësaj Konvente mbi një territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Përsa i përket këtij territori, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të periudhës prej një muaji pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dy paragrafët e mësipërm, që lidhet me çdo territor të përmendur në deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo tërheqje do të kryhet ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 18

1. Çdo Palë, në çdo kohë, mund ta denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim do të kryhet ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Palët, shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Europës, Shtetet e tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane, shtetet joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente dhe çdo shtet që ka aderuar apo është ftuar të aderojë në të:

- a) për çdo nënshkrim në përputhje me nenin 14;
- b) për depozitimin e çdo mjeti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi në përputhje me nenin 14 ose 16;
- c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 15 dhe 16;
- d) për çdo informacion të dhënë sipas dispozitave të nenit 12;
- e) për çdo raport të përgatitur në zbatim të dispozitave të nenit 12;
- f) për çdo propozim për amendament ose çdo amendament të miratuar në përputhje me nenin 13 dhe datën në të cilën do të hyjë në fuqi amendamenti;
- g) për çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit 17;
- h) për çdo njoftim të bërë sipas dispozitave të nenit 18 dhe datës në të cilën do të kryhet denoncimi;

i) për çdo akt, njoftim apo komunikim tjetër që lidhet me këtë Konventë;

Të pranishëm, nëshkruesit e mëposhtëm, të autorizuar për këtë, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 16 nëntor 1989, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet të barasvlefshëm, në një kopje të vetme, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të përcjellë kopje të vërtetuara te çdo shtet anëtar i Këshillit të Europës, te Shtetet e tjera Palë të Konventës Kulturore Europiane, te shtetet joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente dhe te çdo shtet i ftuar për të aderuar në të.

Shtojcë

LISTA REFERUESE PËR KLASAT E NDALUARA FARMAKOLOGJIKE
TË AGJENTËVE DHE METODAVE DOPING

(sipas statusit të datës 1 shtator 2002. Shtojca rishikohet në mënyrë të rregullt nga grupi monitorues mbi bazën e I.listës antidoping të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar)

KLASAT E SUBSTANCAVE DHE METODAVE TË NDALUARA, 2001 – 2002

I. KLASAT E SUBSTANCAVE TË NDALUARA

- A. Stimuluesit
- B. Narkotikët
- C. Agjentët anabolikë
- D. Diuretikët
- E. Hormonet peptide (të tretjes), imitues dhe analogë.

II. METODAT E NDALUARA

III. KLASAT E SUBSTANCAVE TË NDALUARA NË KUSHTE TË CAKTUARA

- A. Alkoholi
- B. Kanabinoidët
- C. Anestezistët lokalë
- D. Glukokortikosteroidët
- E. Beta-blokuesit

IV. TESTET JASHTË GARE

Dokument shpjegues

I. KLASAT E NDALUARA TË SUBSTANCAVE

A. Stimuluesit

Substancat e ndaluara në klasën (A) përfshijnë shembujt e mëposhtëm:

Amineptinë, amifenazol, amfetaminë, bromanan, kafeinë*, karfedon, kokainë, efedrinë**, fenkamfaminë, formoterol***, mesokarb, pentetrazol, pipradol, salbutamol***, salmeterol***, terbutalinë***, ... dhe substanca të afërta me to.

* Për kafeinën, përcaktimi “pozitiv” është përqendrimi në urinë më shumë se sa 12 mikrogramë për mililitër.

** Për katinën, përcaktimi “pozitiv” është përqendrimi në urinë i më shumë se 5 mikrogramëve për mililitër. Për efedrinën dhe metilefedrinën, përcaktimi “pozitiv” është përqendrimi në urinë më shumë sesa 10 mikrogramë për mililitër. Për fenilpropanolaminën dhe pseudoefedrinën, përcaktimi “pozitiv” është përqendrimi në urinë më shumë sesa 25 mikrogramëve për mililitër.

I lejuar nga inhalatori (apart për thithje ilaçi) vetëm për të parandaluar dhe/ose trajtuar astmën dhe astmën e shkaktuar nga ushtrimet. Është i nevojshëm njoftimi me shkrim nga mjeku respirator apo mjeku i ekipit që sportisti është me astmë ose me astmë të shkaktuar nga ushtrimi fizik për autoritetin përkatës mjekësor para gare.

Në Lojërat Olimpike, sportistët që kërkojnë leje për të marrë një agonist beta të lejueshëm, do të vlerësohen nga një grup i pavarur mjekësor.

Shënim. Të gjitha preparatet imidazol janë të pranueshëm për përdorim topikal (term mjekësor). Vazokonstriktorët (enëzorët e muskujve tkurrës) mund të trajtohen me agjentë anestezikë lokalë. Preparatet topikalë (me përdorim lokalë) (p.sh. hundorë, okulistikë, rektalë) të adrenalinës dhe fenilefrinës janë të lejueshëm.

B. Narkotikët

Substancat e ndaluara në klasën (B) përfshijnë shembujt e mëposhtëm:

Morfinë, dekstromoramidë, diamorfinë (heroinë), metadonë, morfinë, pentozocinë...dhe substanca që afrojnë me to.

C. Agjentët anabolikë

Substancat e ndaluara në klasën (C) përfshijnë shembujt e mëposhtëm:

1. Steroidët androgjenikë anabolikë

a) klostebol, fluksimesteron, metandienon, metenolon, nandralon, 19-norandrostenediol, 19-norandrostenedion, oksandrolon, stanozolil, ...dhe substanca të afërta me to.

b) Androstenediol, nadrosteneidon, dehidropiandrosteron, 9DHEA), dihidrotosteron, testosteron*,dhe substanca të afërta me to.

Dëshmitë e marra nga profile metabolikë dhe/ose matjet e raporteve izotopikë mund të përdoren për të nxjerrë konkluzione të sakta.

*Prania e testosteronit (T) në epitestosteron (E) në proporcion më të madh se sa gjashtë (6) në një (1) në urinën e një garisti, përbën një dhunim nëse nuk dëshmohej se ky raport është për shkak të një gjendjeje fiziologjike ose patologjike, p.sh. një sekretim i ulët i epitestosteronit, androgjen që prodhon tumor, deficineca enzimatiqe.

Në rastin e raportit T/E më të lartë se 6, është e detyrueshme që autoriteti përkatës mjekësor të kryejë një hetim para se analiza të deklarohet pozitiv. Do të shkruhet një raport i plotë, i cili do të përfshijë një shqyrtim të testeve të mëparshme, testeve të mëpasme, dhe çdo rezultat të hetimeve të endokrinës. Në rast se testet e mëparshme nuk janë të disponueshme, sportisti duhet të testohet pa u njoftuar të paktën një herë në muaj për tre muaj rresht. Rezultatet e këtij vëzhgimi duhen përfshirë në raport. Pamundësia për të bashkëpunuar në hetime (kërkime) do të rezultojë në deklarimin pozitiv të analizës.

2. Agonistët beta-2

bambuterol, klenbuterol, fenoterol, formoterol*, reproterol, salbutamol*, salmeterol*, terbutalinë*, ... dhe substanca që lidhen me to.

*Të lejuara nga inhalatori (aparati thithës) siç përkrahëhet në nenin (I.A).

Për salbutamol, përcaktimi "pozitiv" sipas kategorisë së agjentëve anabolikë është përqendrimi në urinë i më shumë se 1000 nanogramëve për mililitër.

D. Diuretikët

Substancat e ndaluara në klasën (D) përfshijnë shembujt e mëposhtëm:

Acetazolamidë, bumetadinë, klortalidon, acid etakrinik, furosemidë, hidroklorotiazidë, manitol*, mersalyl, spironolakton, triamteren,... dhe substanca që afrojnë me to.

*Të ndaluara me injektim intravenoz.

E. Hormonet peptide (të tretjes), imitues dhe analoge me to.

Substancat e ndaluara në klasën (E) përfshijnë shembujt e mëposhtëm dhe imituesit dhe analogët me to:

1. Gonadotrofinët kronikë (hCG), të ndaluar vetëm tek meshkujt;
 2. Gonadotrofinë sintetike dhe hipofizarë (LH) të ndaluar vetëm për meshkujt;
 3. Kortikotrofinët (ACTH, tetrakosaktid);
 4. Hormonet e rritjes (hGH);
 5. Insulinë e ngjashme me faktorin e rritjes (IGF-1); dhe të gjithë faktorët respektivë çlirues (lëshues) dhe analogët e tyre;
 6. Eritropoetinë (EPO);
 7. Insulinë;
- të lejuar vetëm për të trajtuar sportistët që vuajnë nga diabeti të kuruar me insulinë. Certifikimi me shkrim i diabetëve të kurueshme me insulinë duhet marrë nga një mjek endokrinolog ose mjeku i ekipit.

Prania e një përqendrimi jonormal i një hormoni endogjen në klasën (E) ose shënjesit të tij diagnostikues (s) në urinën e një garisti përbën një dhunim në qoftë se nuk ka prova që kjo është shkatuar si pasojë e një gjendjeje patologjike apo fiziologjike.

II. METODAT E NDALUARA

Ndalohen procedurat e mëposhtme:

1. Dopingi i gjakut: nënkupton administrimin e gjakut të një sportisti, qelizave të kuqe të gjakut dhe/ose të produkteve që lidhen me gjakun, të cilat mund të procedohen nga marrja e gjakut nga sportisti, i cili vazhdon të stërvitet në një gjendje të tillë gjakzbrazës;
2. Administrimi i mbajtësve artificialë të oksigjenit ose zhvilluesve të plazmës;
3. Manipulimet farmakologjike, kimike dhe fizike.